



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 197, Datë 18.09.2024

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 175, DATË 04.11.2020
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MALI”
ME KAPACITET TË INSTALUAR 1490 KW, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1815/1 prot., datë 13.09.2024 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr.175, datë 04.11.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW, i ndryshuar”.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 175, datë 04.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr.107, datë 31.05.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mali”, me kapacitet të instaluar 1490 kW, për një afat 30 vjeçar, me kushtin që të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga Hec “Mali” brenda datës 23.09.2024.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr.1815 prot., datë 23.08.2024, shoqëria brenda afatit të vendosur në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s, ka depozituar Vendimin e Këshillit të Basenit Ujqor (KBU) Ishëm, me Nr.10, datë 17.07.2024, për miratimin e “Kërkesës për rinovimin e kushteve të lejes” dhe lejen për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor nr. 13/8 prot., datë 04.08.2024, me nr. 000078 serie, të miratuar me Vendim e KBU Ishëm me nr.10, datë 17.07.2024, për prodhim hidroenergje nga Hec “Mali”. Në këtë leje përcaktohet **se periudha e vlefshmërisë së saj është për 5 (pesë) vite, deri më datën 17.07.2029.**
- Me depozitim të këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.05.2024, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kusht shoqërisë që të

depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergji nga HEC “Mali” *brenda datës 17.07.2029*.

- Me ndryshimin e pikës 3 dhe në kuadër të unifikimit me praktikatat e tjera të ngjashme, vlerësojmë të ndryshohet dhe pika 4, e vendimit të bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.05.2024, sikurse shprehur në dispozitiv.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit apo plotësimit të aktit të parë, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr.107, datë 31.05.2024, ndryshon dhe bëhet:

3. Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. duhet të depozitohet në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergji nga Hec “Mali” brenda datës 17.07.2029.

2. Pika 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.05.2024 ndryshon dhe bëhet:

4. Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI